

VENDIM
Nr. 627, datë 7.9.2016

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 190, DATË 3.5.1995, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 7874, DATË 17.11.1994, "PËR STATUSIN E VETERANIT TË LUFTËS ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE TË POPULLIT SHQIPTAR"', TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8 e 14, të ligjit nr. 7874, datë 17.11.1994, "Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 190, datë 3.5.1995, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

1. Pika 16 ndryshohet me këtë përmbajtje:

"16. Komisioni qendror për dhënien e statusit të veteranit të LANÇ-it të popullit shqiptar i dërgon Institutit të Sigurimeve Shoqërore një kopje origjinale të vendimit për dhënien e statusit të veteranit, ku përcaktohet identiteti i personit që e ka fituar këtë status dhe masa e shpërblimit që ai përfiton, sipas këtij vendimi."

2. Në pikën 23, pas shkronjës "b", shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

"Dëshmia "Familje veterani" jepet me firmë të kryetarit të komisionit qendror për dhënien e statusit të veteranit të LANÇ-it të popullit shqiptar dhe me kërkesë të një pjesëtari të familjes së veteranit, i cili duhet të paraqesë dhe këto dokumente:

- librezën e veteranit të ndarë nga jeta;
- certifikatën e vdekjes së veteranit;
- certifikatë familjare të kërkuarit."

3. Paragrafi i fundit i pikës 26 ndryshohet si më poshtë vijon:

"Komisioni qendror për dhënien e statusit të veteranit të LANÇ-it të popullit shqiptar dhe stafi teknik i tij, në përjashtim nga sa është thënë në paragrafët e mësipërm, të vazhdojë veprimtarinë e tij, duke u mbledhur, të paktën një herë në vit, për shqyrtimin e kërkesave të personave që e fitojnë statusin e veteranit ose të drejtën për t'u shqyrtuar nga ky komision me vendim gjykatë të formës së prerë. Këto kërkesa, bashkë me vendimin e gjykatës së formës së prerë, adresohen në Ministrinë e Mbrojtjes.

Stafi teknik i komisionit qendror për dhënien e statusit "Dëshmor i Atdheut", i përcaktuar në vendimin nr. 151, datë 25.4.2002, "Për statusin "Dëshmor i Atdheut"', të ndryshuar, të shërbejë si staf teknik edhe për komisionin qendror për dhënien e statusit të veteranit të LANÇ-it të popullit shqiptar.

Përjashtimisht për vitin 2016, komisioni të ngrihet vetëm për shqyrtimin e kërkesave të personave që u është njohur statusi i veteranit me vendim gjykatë të formës së prerë."

4. Lista e përbërjes së komisionit qendror për dhënien e statusit të veteranit të LANÇ-it të popullit shqiptar, bashkëlidhur vendimit nr. 190, datë 3.5.1995, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet me listën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë e pandarë e tij."

5. Pas pikës 26 të shtohet pika 27 me këtë përmbajtje:

"27. Trajtimi financiar për personat që kanë fituar të drejtën për t'u shqyrtuar nga komisioni qendror për dhënien e statusit të veteranit të LANÇ-it të popullit shqiptar me vendim gjykatë të formës së prerë, në rast se komisioni u njeh statusin e veteranit, fillon nga data e marrjes së vendimit të komisionit."

6. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lista nr. 1

**PËRBËRJA E KOMISIONIT QENDROR PËR DHËNIEN E STATUSIT TË VETERANIT TË
LUFTËS ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE TË POPULLIT SHQIPTAR**

- | | |
|--|----------|
| 1. Zëvendësministri i Mbrojtjes | kryetar; |
| 2. Drejtori i Drejtorisë së Arsimit dhe Përkujdesjes Sociale të
Ushtarakëve | anëtar; |
| 3. Përfaqësuesi i Institutit të Sigurimeve Shoqërore | anëtar; |
| 4. Një përfaqësues i strukturës juridike në Ministrinë e Mbrojtjes | anëtar; |
| 5. Drejtori i Arkivit Qendror të Forcave të Armatosura | anëtar; |
| 6. Një specialist i Arkivit Qendror të Shtetit | anëtar; |
| 7. Një përfaqësues i Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të
Luftës | anëtar; |
| 8. Një përfaqësues të Organizatave së Invalidëve të Luftës dhe të
Ushtrisë | anëtar; |
| 9. Një përfaqësues i Organizatës së Veteranëve të Luftës
Antifashiste Nacionalçlirimtare të Popullit Shqiptar | anëtar. |